

Tiranë, më 10/12/2025

**RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
„PËR BUXHETIN E VITIT 2026“**

Të nderuar anëtarë të Këshillit Kombëtarë,

Projektbuxheti i vitit 2026 mbështet konsolidimin e mëtejshëm të objektivave që do të çojnë në ofrimin e më shumë shërbimeve për anëtarët, në përmbushjen e misionit të Urdhrit ,për rrjedhojë në gjenerimin e të ardhurave për realizimin e këtij misioni si dhe administrimin e tyre në mënyrë efikase .

Gjatë vitit 2025 i gjithë aktiviteti i Aparatit Qëndror, i drejtuar nga organet vendim marrëse , u fokusua në realizimin e misionit për të cilën është krijuar Urdhri.

Gjatë këtij viti është organizuar puna për regjistrimin e farmacistëve të rinj në regjistrin kombëtarë, kundrejt përmbushjes së kërkesave ligjore , regjistrimin e ndryshimeve të anëtareve të Urdhrit, që vijnë si rezultat i ndryshimit të vendit të punës por dhe i atyre që mbushin afatin kohorë të regjistrimit në funksionin e Drejtuesit Teknik.

Një vëmendje të veçantë i është kushtuar regjistrimit të studentëve që vijnë nga auditorët, për kryerjen e praktikës profesionale si detyrim ligjorë pranë urdhrit, mbikqyrjen e tyre në çdo farmaci .

Gjithashtu , në kuadër të organizimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim, gjatë këtij viti janë organizuar pesë bashkëorganizime me operatorë të tjerë si:

Kongresi me Odën e Kosovës në datat 24-25 Maj 2025 , në Prishtinë.

Trajnimi në bashkëpunim me kompaninë „EUREKA“ me 9 kredite,

Qendra e Shëndetit dhe Mirqenies komunitare“Depresioni dhe vetëvrasja,menaxhimi dhe trajtimi i sukseseshem“,me 3 Kredite .

Me shoqatën mjekësore „Brainstorm“ në datat 09-10-11 Maj 2024, me 18 kredite.

Me shoqatën Mjekësore „Brainstorm“ në datat 21-22-23 Nëntor 2025 , me 18 kredite.

Cikël leksionesh të ofruara nga Urdhri me temë „Parandalimi dhe mjekimi i sëmundjeve metabolike dhe kardiovaskulare“ ,pa pagesë ,në datat 26-29-30 Dhjetor , me 5 kredite,

Në total gjatë vitit 2025 nga Urdhri janë ofruar 53 kredite farmacistëve, të mjaftueshme për të plotësuar kërkesat e ligjit.

Ricertifikimi i farmacistëve vazhdoi dhe gjatë vitit 2025, sidomos në tremujorin e parë të tij. Kërkesat kryesore ishin pagesa e detyrimeve financiare ndaj Urdhrit si dhe marrja e numërit të nevojshëm të krediteve të percaktuara nga ligji. Falë këtij procesi u bë arketimi i detyrimeve të prapambetura që farmacistët kishin tek urdhri, dhe sic dhe e vërtetojnë dhe pasqyrat financiare detyrimi zinte një vlerë të konsiderueshme.

Gjatë vitit 2025, një vemendje të vecantë ju kushtua dhe datës 25 Shtator, ditës botërore të Farmacistit.

Në nder të kësaj date , Urdhri organizoi aktivitetin,në Shtëpinë e të moshuarve Tiranë , duke i ofruar materiale mjeksore dhe barna në bashkëpunim me kompanitë farmaceutike , si dhe organizoi tenda në pesë pika në Sheshin Skenderbe dhe Piramida për matje tensioni, glicemie dhe dhënien e këshillave për popullsinë .Fokusi kryesor ishte ndërgjegjësimi i popullsisë lidhur me kontrollin e shëndetit.

Aktivitetet u pasqyruar në media , dhe u pritën shumë mirë nga pjesëmarrësit.

BUXHETI I VITIT 2026

1- Objektivat e Buxhetit 2026

Krijimi i një sistemi për realizimin dhe evidentimin e të ardhurave në përgjithësi dhe të ardhurave nga kuotat mujore në veçanti, së pari nëpërmjet

rritjes së bazës së atyre që do të paguajnë kuotat mujore, dhe së dyti nëpërmjet evidentimit , saktësimit të anëtareve që ushtrojnë profesionin nëpërmjet mbikqyrjes profesionale dhe bashkëpunimit me institucionet e tjera.

2- Detajimi i Buxhetit për vitin 2026

Hartimi i Projektbuxhetit është mbështetur në realizimin faktik të vitit 2025, objektivat që Urdhri ka për vitin 2026, janë pasqyruar efektet e normës së inflacionit prej 2.5 %, duke përfshirë të gjithë faktorët që ndikojnë si për realizimin e të ardhurave, ashtu dhe për përdorimin e shpenzimeve .

Buxheti është i detajuar sipas natyrës ekonomike.

Buxheti parashikohet të jetë i balancuar.

2.1 Planifikimi i të Ardhurave

Planifikimi i të Ardhurave bazohet nga të dhënat që disponojmë si:

- Numëri i anëtarëve të Urdhrit të regjistruar në Regjistrin Kombëtarë në funksionin e Drejtuesit Teknik.
- Numri i anëtarëve të Urdhrit të regjistruar në Regjistrin Kombëtarë , në funksionin e Farmacistit të punësuar.
- Numëri i anëtarëve të Urdhrit të regjistruar në Regjistrin e Vecantë , të Ndihmës Farmacistëve.
- Numëri i antarësimeve të reja , referuar regjistrimeve të kandidatëve për provimin e Shtetit për dy sezonet Maj- Dhjetor 2025.
- Numëri i praktikantëve të regjistruar për praktikën profesionale viti 2025.
- Numëri i anëtarëve që mund të rilicensohen.
- Në realizimin e të ardhurave për periudhën si dhe i pritshmi deri në fund të vitit 2025.
- Në të ardhurat e gjeneruara lidhur me shërbimet që urdhri i ofron anëtarëve ,si vërtetime për jashtë shtetit,etj.

Të dhënat për planifikimin e të Ardhurave për vitin 2026 krahasuar me vitin 2025 paraqiten si më poshtë:


000/lekë

Nr	Emertimi	Plani 2025	Plani 2026	Në %
	TE ARDHURA			
1	Kuota antarësimi	30.330	29.382	3.12%
	- Drejtues Teknik	20.940	20.412	↓
	- Farmacist i punësuar	8.424	8.160	
	- Nd/farmacist	966	810	
2	Regjistrimet e reja	3.070	3.975	↑ 29.48%
3	Praktika Profesionale	2.970	2.780	↓ 6%
4	Të Tjera (riprintime)	1.362	1.666	↑ 22.32%
5	Likujditetet	28.581	12.000	
6	Të drejta të arkëtueshme	0	15.370	
	TOTALI	66.312	65.173	↓ 1.71%

Referuar zerave të të Ardhurave, shikojmë se të ardhurat krahasuar me vitin 2025 kanë pësuar një rënie të lehtë. Kjo rënie i referohet zërit të të ardhurave nga kuotizacionet në masën 3.12%. Gjithashtu kemi rritje në të ardhurat nga regjistrimet e reja, dhe zëri të Tjera.

Është e pritshme rënia e të ardhurave nga zëri i kuotizacioneve të Ndihmës Farmacistëve, pasi legjislacioni për arsimin në vendin tonë nuk përgatit më Ndihmës Farmacistë.

Ecuria e të ardhurave nga viti 2025 në vitin 2026 paraqitet grafikisht si më poshtë:




- ✓ **Të Ardhura nga kuotat e anëtarëve që ushtrojnë funksionin e Drejtuesit Teknik** , janë bazuar në numërin e regjistrimeve të nxjerra nga zyra e regjistrimit me parashikim deri në Dhjetor 2025,gjithësej 1,701 anëtarë.
- ✓ **Të Ardhura nga kuotat e antarëve Farmacist të punësuar**, janë bazuar në numërin e regjistrimeve të nxjerra nga zyra e regjistrimit me parashikim deri në Dhjetor 2025, gjithësej 1,360 anëtarë.
- ✓ **Të Ardhura nga kuotat e Nd/farmacistëve** , janë bazuar në numërin e regjistrimeve të nxjerra nga zyra e regjistrimit deri në Dhjetor 2025,gjithësej 70 anëtarë.
- ✓ **Të Ardhurat nga Tarifat e Regjistrimeve të reja**, janë bazuar në numrin e studentëve të regjistruar për provimin e Shtetit Maj 2025 dhe Dhjetor 2025.
- ✓ **Të ardhura nga Praktika**, janë bazuar në numërin e praktikantëve të regjistruar gjatë vitit 2025 për të dy zezonet Korrik 2025 dhe Dhjetor 2025 , gjithësej 271 praktikantë . Në këtë grup të ardhurash janë përfshirë dhe të ardhurat nga tarifa e regjistrimit për praktikantët që regjistrohen si përsëritës të provimit të aftësimit praktik, gjithësej sipas të dhënave të zyrës së praktikës për vitin 2025 janë 70

praktikantë.

- ✓ **Të ardhura të tjera (riprintime, ricertifikime, shërbime etj)**, janë bazuar në numërin e antarëve aktiv ,drejtues teknik dhe farmacistë të punësuar me parashikim deri në Dhjetor 2025.

Planifikimi i të Ardhurave për vitin 2026 sipas peshës specifike të tyre , paraqitet si vijon:



Realizimi i të ardhura , që përbën bazën e realizimit të objektivave të Urdhrit kërkon punën e të gjithë organeve të Urdhrit ,si atyre të zgjedhur ,ashtu dhe atyre të emëruar.

2.2 SHPENZIMET 2026

Shpenzimet janë planifikuar sipas strukturës ekonomike , dhe kanë për qëllim mbulimin e aktivitetit të Urdhrit për vitin 2026 , për realizimin e misionit të Urdhrit që do të përkthehet në rritjen e nivelit të Shërbimit Farmaceutik.

Ndarja sipas strukturës Ekonomike .

- 1- **Shpenzimet e personelit**, të cilat janë përcaktuar sipas numërit të punonjësve të miratuar në Këshillin Kombëtar dhe pozicioneve të tyre në strukturë. Në këtë zë përfshihen pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetsore si dhe Fondi i Veçantë.
- 2- **Shpenzime për Honorare**, janë shpenzimet për pagesat e honorarëve mujore të anëtareve të Këshillave Rajonal dhe pagesat për ditëmbledhje të Këshillit Kombëtarë ,Këshillave Rajonal ,si dhe honorarët për antarët e komisioneve të ndryshme të ngritura pranë Urdhrit, referuar nivelit të honorarit të miratuar nga Këshilli Kombëtar.
- 3- **Shpenzime Operative**, janë llogaritur për funksionimin normal të punës së administratës së Aparatit Qëndrorë dhe funksionimin e strukturave Rajonale. Në këtë strukturë përfshihen shpenzimet për kancelari, shtypshkrime, bojë për printerat, shpenzime për shërbime si energji elektrike , uje, telefon , taksa vendore,auditime, shpenzime dieta, pritje percjellje, etj.
- 4- **Shpenzime për Qira** , janë shpenzimet për mbulimin e pagesës së qirasë së objektit të marrë me qira nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë për zyra. Për vitin 2026 është parashikuar shpenzime për qira vetëm për tre mujorin e parë 2026, pasi parashikojmë të kalojmë në ambientet e zyrave te urdhrit.
- 5- **Investime përpërshatajen e objektit të blerë për zyra dhe pajisje Zyre**. Në këtë zë shpenzimesh janë përfshirë shpenzimet për përshtatjen e objektit të blerë për zyra, procesh që ka filluar që në vitin 2025 , si dhe shpenzime për blerje të pajisje për zyrat si ato elektronike dhe ato mobilare .
- 6- **Shpenzime kredie dhe interesa**. Në këtë zë janë përfshirë shpenzimet per pagimin e kështit të kredisë , ku përfshihen dhe interest sipas planit të amortizimit të kredisë të përcaktuar nga Banka Credin.

- 7- **Shpenzime për aktivitete të Edukimit në Vazhdim**, janë projektet që do të realizohen për aktivitete të Edukimit në Vazhdim në fushën Farmaceutike , duke bërë të mundur ofrimin e një numëri të mjaftueshëm për farmacistët.


Planifikimi i Shpenzimeve për vitin 2026 krahasuar me vitin 2025 paraqitet sipas tabelës:

000/lekë


Nr.	Emërtimi	Plani 2026	Plani 2025
	SHPENZIMET		
1	Paga dhe shpërblime	21.819	20.999
2	Fondi i Veçantë	1.063	1.022
3	Kontributet e sig. shoqerore e shendetsore	3.821	3.677
4	Honorare	10.362	11.202
5	Shpenzime operative	2.850	4.200
6	Qira zyresh	543	1.086
7	Investime	18.344	21.127
8	Aktivitete të Edukimit në vazhdim	1.000	3.000
9	Kredia	5.371	0
	TOTALI	65.173	66.313

Siç shihet dhe nga tabela krahasuar më Buxhetin e vitit 2025, kemi një ulje prej 1.71% në Buxhetin e vitit 2026. Kjo ulje i përket zërit të shpenzimeve operative, shpenzimeve për qiranë , investimeve, dhe edukimit në vazhdim. Gjatë këtij viti një zë të rëndësishëm në shpenzime, është zëri për shpenzime Kredie, që është marrë për blerjen e zyrave, dhe që do të vazhdojë për një periudhë dhjetë vjecare.

Dhe në mënyrë grafike niveli i shpenzimeve për vitin 2026 në krahasim me vitin 2025 paraqiten si vijon:



Niveli i shpenzimeve për vitin 2026, sipas peshës specifike të tyre në mënyrë grafike paraqiten si vijon:



Realizimi i zërave të shpenzimeve do të bëjë të mundur realizimin e projekteve që urdhri ka për vitin 2026.

Zbatimi i Buxhetit, do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

Arkëtimet, do të vazhdojnë të bëhen vetëm nëpërmjet sistemit bankar , i vërtetuar me mandate arkëtimi të bankës.

Shpenzimet , do të bëhen sipas procedurave të përcaktuara dhe të mbështetura në dokumenta standarte të miratuara për Financat dhe për Kontabilitetin.

Ndjekja dhe zbatimi i Buxhetit, do të bëhet nga Aparati Qendrorë i Urdhrit. Gjithë dokumentacini për shpenzimet që do të realizohen do të depozitohet në Zyrën e Financës për likuidim.

Këto ishin treguesit e Buxhetit të vitit 2026.

Ju ftoj për miratimin e Buxhetit të vitit 2026.

ZYRA E FINANCËS
MIRSIE DOKA